

Termat e Referencës për Ekspert për Vlerësimin Socio-Ekonomik në Korridorin Ekologjik

1. Sfondi dhe Konteksti

EcoAlbania është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2014, me qëllim mbrojtjen e ekosistemeve natyrore dhe promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Shqipëri. Veprimtaria e saj përqëndrohet në kërkimin shkencor, angazhimin e komunitetit, advokimin e politikave, ndërgjegjësimin, dhe edukimin mjedisor, me synim mbrojtjen e biodiversitetit dhe të habitateve në vend. EcoAlbania bashkëpunon ngushtë me komunitetet lokale, institucionet, dhe shoqërinë civile, si dhe mbështet iniciativa ndërkufitare përmes partneriteteve në rajon.

Aktualisht, EcoAlbania po zbaton projektin **CONNECTA**, i financuar nga **Prespa Ohrid Nature Trust (PONT)**. Ky projekt synon ruajtjen dhe përmirësimin e konektivitetit ekologjik përmes forcimit të qeverisjes pjesëmarrëse, zbatimit të masave prioritare për restaurim dhe menaxhim, zgjerimit të njohurive mbi korridoret ekologjike, si dhe rritjes së bashkëpunimit përtej kufijve administrativë dhe kombëtarë në Shqipërinë Juglindore.

CONNECTA bazohet në rezultatet e projektit ISCCA (2023-2026), me fokus në pjesën veriore të Korridorit Ekologjik Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz, ku presionet dhe aktivitetet prioritare u identifikuan përmes një procesi pjesëmarrës. Projekti CONNECTA vijon punën e nisur duke mbështetur zbatimin e masave prioritare në pjesën veriore të korridorit, ndërsa shtrin aktivitetet edhe në pjesën jugore të tij. Në këtë zonë do të ndërmerren procese të ngjashme, përfshirë angazhimin e palëve të interesit dhe identifikimin e presioneve mjedisore. Paralelisht, projekti po mbështet bashkëpunimin ndërkufitar në pellgun Aoos/Vjosë, përmes nismave të përbashkëta me partnerin tonë në Greqi, MedINA.

Për të mbështetur zbatimin efektiv të aktiviteteve të planifikuara për pjesën jugore të korridorit, EcoAlbania kërkon të prokurojë shërbime për vlerësimin socio-ekonomik në zonë, siç përshkruhet në këto Terma Reference.

2. Qëllimi i Detyrës / Prokurimit

Qëllimi i kësaj procedure prokurimi është angazhimi i një eksperti/konsulenti të kualifikuar për të realizuar një vlerësim socio-ekonomik mbi potencialin e zhvillimit të ekoturizmit dhe agroturizmit në pjesën jugore të Korridorit Ekologjik Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz, në kuadër të projektit CONNECTA.



Ky angazhim synon të analizojë potencialin ekzistues të zonës për zhvillimin e modeleve të qëndrueshme të ekoturizmit dhe agroturizmit, duke vlerësuar burimet natyrore dhe kulturore, kapacitetet lokale, aktivitetet ekonomike ekzistuese, si dhe sfidat e mundësitë për përfshirjen e komuniteteve në këto sektorë. Rezultatet e këtij vlerësimi do të mbështesin planifikimin dhe zbatimin efektiv të projektit, duke ofruar një bazë të qartë informacioni për identifikimin e prioriteteve strategjike, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm lokal dhe forcimin e ndërveprimit ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe mundësive ekonomike në këtë pjesë të korridorit.

3. Fusha e Punës / Specifikimet Teknike

Ky angazhim konsiston në ofrimin e shërbimeve për realizimin e një vlerësimi socio-ekonomik mbi potencialin e zhvillimit të ekoturizmit dhe agroturizmit në pjesën jugore të Korridorit Ekologjik Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz, duke mbuluar bashkitë Maliq, Korçë, Skrapar, Devoll dhe Kolonjë, siç paraqitet në hartën e dhënë në **Aneksin 2**. Ky proces do t'i mundësojë EcoAlbania-s një kuptim të qartë të karakteristikave socio-ekonomike të zonës, potencialet ekzistuese për zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme turistike, si dhe mundësitë për përfshirjen e komuniteteve lokale në mbështetje të objektivave të projektit CONNECTA.

Eksperti do të jetë përgjegjës për realizimin e një analize të potencialit të ekoturizmit dhe agroturizmit në zonën e projektit, duke vlerësuar burimet natyrore, vlerat kulturore, aktivitetet ekonomike ekzistuese, kapacitetet lokale, si dhe iniciativat apo praktikatat aktuale që lidhen me zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Analiza duhet të identifikojë mundësitë për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve turistike që janë në përputhje me ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe forcimin e ekonomive lokale.

Gjithashtu, kërkohet një vlerësim i aspekteve socio-ekonomike që ndikojnë në zhvillimin e këtyre sektorëve, duke përfshirë kapacitetet e komuniteteve lokale, aktorët relevantë, strukturat ekzistuese të mbështetjes, kuadrin institucional dhe politikat apo skemat që lidhen me ekoturizmin, agroturizmin dhe zhvillimin rural. Pjesë e kësaj analize do të jetë identifikimi i sfidave, kufizimeve dhe mundësive kryesore që ndikojnë në zhvillimin afatgjatë të këtyre aktiviteteve në zonë.

Bazuar në gjetjet e mësipërme, do të hartohen rekomandime praktike për promovimin e modeleve të qëndrueshme të ekoturizmit dhe agroturizmit, duke synuar mbështetjen e komuniteteve lokale, diversifikimin e mundësive ekonomike dhe integrimin e këtyre aktiviteteve me objektivat e ruajtjes së lidhshmërisë ekologjike. Produkti përfundimtar i kësaj detyre do të përfshijë një raport të plotë të vlerësimit socio-ekonomik, i cili përmban analizën e potencialeve ekzistuese, kapaciteteve dhe sfidave kryesore, si dhe rekomandimet për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në këtë pjesë të korridorit.

4. Prurjet dhe Afatet Kohore

Furnizimi / Rezultati	Afati
Plani i punës dhe qasja metodologjike	24/09/2026
Draft-Raporti i Vlerësimit Socio-Ekonomik	09/10/2026
Raporti Final i Vlerësimit Socio-Ekonomik me komentet dhe sugjerimet e reflektuara	16/10/2026

5. Kohëzgjatja dhe Vendndodhja

- **Kohëzgjatja:** 21/09/2026 deri më 16/10/2026 (20 ditë pune)
- **Vendndodhja:** Tiranë, Shqipëri

6. Kualifikimet e Kërkuara / Kriteret e Përshtatshmërisë

- Diplomë Master në Ekonomi, Zhvillim Rural, Turizëm, Menaxhim Mjedisor, Shkenca Sociale, Zhvillim të Qëndrueshëm, ose fusha të ngjashme. Përvoja e dëshmuar profesionale në analizat socio-ekonomike, zhvillimin rural, turizmin e qëndrueshëm ose menaxhimin e burimeve natyrore mund të konsiderohet e barasvlefshme.
- Minimumi 7 vite përvojë profesionale në realizimin e vlerësimeve socio-ekonomike, analizave të territorit, studimeve të zhvillimit lokal, turizmin e qëndrueshëm, ekoturizmit, agroturizmit, ose fushave të ngjashme.
- Përvojë e dëshmuar në realizimin e analizave mbi potencialin turistik, zhvillimin e produkteve turistike, vlerësimin e kapaciteteve lokale dhe identifikimin e mundësive për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në zona rurale.
- Njohje e mirë e kuadrit institucional dhe politikave relevante në Shqipëri lidhur me zhvillimin rural, turizmin, agroturizmin, zhvillimin vendor dhe menaxhimin e territorit, përfshirë përvojën e bashkëpunimit me institucione publike dhe aktorë lokalë.
- Përvojë e dëshmuar në hartimin e raporteve teknike dhe dokumenteve analitike, përfshirë analizën e të dhënave, identifikimin e sfidave dhe mundësive, si dhe formulimin e rekomandimeve praktike.
- Aftësi të mira në analizimin e faktorëve socio-ekonomikë dhe në vlerësimin e lidhjes ndërmjet zhvillimit ekonomik lokal, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjes së vlerave mjedisore.
- Aftësi shumë të mira shkrimi dhe komunikimi në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të respektuar afatet e caktuara.

7. Buxheti dhe Kushtet e Pagesës

- Buxheti duhet të paraqitet në Euro.
- Pagesa do të bëhet në dy kështe: 30% pas nënshkrimit të kontratës dhe 70% pas dorëzimit të produkteve të dakordësuara.
- TVSH duhet të përfshihet në çmim.

8. Kriteret e Vlerësimit

Kriteri	Pesha (%)
Propozimi Teknik	50%
Oferta Financiare	30%
Përshtatshmëria	20%

9. Udhëzime për Dorëzimin

- Afati i dorëzimit: 15/09/2026, ora 17:00 (sipas orës lokale)
- Adresa e email-it për dorëzim: contact@ecoalbania.org dhe k.pepa@ecoalbania.org
- Dokumentet e kërkuara: Formulari i propozimit (në fund të këtij dokumenti), CV/Portofoli, Referenca, Certifikata e Regjistrimit të Subjektit, etj.

10. Konsiderata Etike dhe Konflikti i Interesit

Kodi i etikës së EcoAlbania duhet të respektohet dhe çdo konflikt i mundshëm interesi duhet të deklarohet nga ofruesi.

Aneksi 1

- **Detyra 1:** Shqyrtimi i dokumentacionit dhe përgatitja e planit të punës

Eksperti do të shqyrtojë dokumentacionin përkatës të vënë në dispozicion nga EcoAlbania, informacionet ekzistuese mbi zonën e studimit, dokumentet strategjike dhe burimet e tjera të nevojshme për realizimin e vlerësimit. Bazuar në këtë shqyrtim, do të përgatisë planin e punës dhe metodologjinë e propozuar, duke përcaktuar qasjen e analizës, burimet e informacionit dhe strukturën e raportit final.

- **Detyra 2:** Realizimi i vlerësimit socio-ekonomik mbi potencialin e ekoturizmit dhe agroturizmit

Eksperti do të realizojë një analizë të integruar të potencialit socio-ekonomik të pjesës jugore të Korridorit Ekologjik Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz, me fokus në identifikimin e mundësive për zhvillimin e ekoturizmit dhe agroturizmit. Vlerësimi do të përfshijë analizën e burimeve natyrore, vlerave kulturore, karakteristikat socio-ekonomike të komuniteteve lokale, aktivitetet ekonomike ekzistuese, kapacitetet lokale, iniciativat aktuale turistike dhe potencialit për krijimin apo përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve të qëndrueshme turistike. Gjithashtu, analiza do të identifikojë sfidat, kufizimet dhe mundësitë që ndikojnë në zhvillimin e këtyre sektorëve, si dhe lidhjen e tyre me ruajtjen e vlerave natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

- **Detyra 3:** Hartimi i raportit dhe rekomandimeve

Eksperti do të përgatisë Draft-Raportin dhe më pas Raportin Final, duke reflektuar komentet dhe sugjerimet e EcoAlbania-s. Raporti Final duhet të përfshijë gjetjet kryesore mbi potencialin e ekoturizmit dhe agroturizmit në zonë, analizën e kapaciteteve dhe sfidave ekzistuese, si dhe rekomandimeve praktike për promovimin e modeleve të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik lokal në përputhje me objektivat e projektit CONNECTA.

Aneksi 2




Figura 1: Hartë e Zonës së Projektit CONNECTA (Pjesa Jugore e Korridorit Ekologjik Polis-Valamarë-Rungajë-Moravë-Gramoz)

Kjo hartë paraqet shtrirjen gjeografike të pjesës jugore të Korridorit Ekologjik që mbulohet nga projekti CONNECTA, duke përfshirë bashkitë Maliq, Korçë, Skrapar, Devoll, dhe Kolonjë.

Formulari i Propozimit

Emri i kompanisë së aplikantit/ëve:	
Adresa:	
E-mail:	
Përfaqësuesi ligjor (emri dhe pozicioni):	
Data e ofertës:	
Vlefshmëria (minimumi 30 ditë):	
Nënshkrimi dhe vula:	

Oferta e çmimit *:	
Numri i ditëve:	
Tarifa ditore:	
Çmimi total (neto):	
Shuma e TVSH-së (%):	
Çmimi total duke përfshirë TVSH-në:	

* Çmimi përfshin punën, koston e udhëtimit dhe të gjitha kostot e tjera të lidhura me zbatimin e shërbimeve të sipërpërmendura. Palës së kontraktuar nuk do t'i njihen dhe nuk mund të kërkojë shpenzime shtesë përtej çmimit të dakordësuar.

Deklarata e ofertuesit

Ofertuesi deklaron me dorëzimin e kësaj oferte

- se është në dijeni të rregulloreve të tenderit,
- se ai ka autorizimin për të ekzekutuar kërkesën
- se ai do të angazhojë, sipas kërkesave punonjësit, konsulentët dhe anëtarët e tjerë të stafit të nevojshëm për të përmbushur kërkesat dhe afatet e tenderuara
- se ai do të ofrojë shërbimin e ofruar sipas kushteve dhe çmimeve të cituara
- se oferta e tij mbetet e detyruese deri në përfundimin e afatit të pranimit të tenderit

Vëndi, Data

Nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor